

AKT NORMATIV
Nr. 14, datë 5.10.2022

**PËR MARRJEN E MASAVE TË VEÇANTA GJATË KOHËZGJATJES SË
GJENDJES SË EMERGJENCËS NË FURNIZIMIN ME ENERGJI ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1
Objekti dhe subjektet

1. Objekt i këtij akti normativ është përcaktimi i masave detyruese, që merren gjatë gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike, me qëllim uljen e konsumit të energjisë elektrike.
2. Subjekt i këtij akti normativ janë të gjithë klientët familjarë dhe jofamiljarë, publikë dhe privatë të energjisë elektrike.

Neni 2
Qëllimi

Ky akt normativ ka për qëllim forcimin e zbatimit të masave dhe rregullave të detyrueshme për t'u zbatuar, me qëllim uljen e konsumit të energjisë elektrike, gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike.

Neni 3
Termet e përdorur

1. Termet e përdorur në këtë akt normativ kanë të njëjtin kuptim me atë të përcaktuar në ligjin nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar.
2. "Task-Forca e Energjisë" është struktura e posaçme e ngritur me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të OSHEE Group, sh.a.

Neni 4
Ulja e konsumit nga klientët jofamiljarë publikë

1. Klientët jofamiljarë publikë zbatojnë masat e nevojshme për reduktimin e konsumit të energjisë elektrike të godinave të tyre, në masën 15 % , krahasuar me muajin përkatës të një viti më parë.
2. Titullarët e institucioneve të qeverisjes qendrore, institucioneve të pavarura, institucioneve të varësisë, njësitë e vetëqeverisjes vendore, si dhe administratorët e shoqërive dhe ndërmarrjeve publike caktojnë me urdhër një nga punonjësit në rolin e administratorit energjetik, i cili është përgjegjës për:
 - a) raportimin pranë Task-Forcës së Energjisë brenda 7 (shtatë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij akti normativ;
 - b) verifikimin e të gjitha pajisjeve që konsumojnë energji elektrike në institucion;
 - c) zbatimin e masave që sjellin reduktimin e energjisë elektrike së konsumuar;
 - ç) raportimin e konsumit të energjisë elektrike në bazë mujore te Task-Forca e Energjisë, duke identifikuar kursimet e arritura në raport me muajin përkatës të vitit paraardhës dhe raportimin e masave të zbatuara.

3. Administratori energjetik raporton në mënyrë periodike te titullari i institucionit apo administratori i shoqërisë dhe ndërmarrjes për kursimin e arritur dhe masat shtesë që duhen ndërmarrë.

4. Mosarritja e përsëritur në dy muaj e masës së kursimit të energjisë nga institucioni, shoqëria apo ndërmarrja konsiderohet shkelje administrative dhe dënohet me gjobë, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë. Masa administrative i vendoset titullarit të institucionit, administratorit të shoqërisë apo ndërmarrjes, që ka përgjegjësi administrimi pronën përkatëse.

Neni 5

Masat e veçanta për klientët jofamiljarë publikë

1. Klientët jofamiljarë publikë, përveç detyrimit të përcaktuar në nenin 4, të këtij akti normativ, zbatojnë edhe masat e detyrueshme për reduktimin e konsumit të energjisë elektrike, sipas parashikimeve të mëposhtme:

a) Ndalohet përdorimi i ajrit të kondicionuar në temperaturë më të ulët se 27 gradë gjatë verës dhe më të lartë se 21 gradë gjatë dimrit;

b) Ndërpritet ndriçimi i jashtëm i godinave të klientëve jofamiljarë publikë çdo ditë pas orës 22:00;

c) Ndërpritet ndriçimi rrugor i rrugëve ndërqytetase kryesore dhe dytësore;

ç) Ndërpritet ndriçimi i jashtëm i objekteve të kulturës, monumenteve, shesheve, shatërvanëve.

2. Nga zbatimi i pikës 1, të këtij neni, përjashtohet ndriçimi i rrugëve të qytetit.

3. Shkelja e detyrimeve të këtij neni konsiderohet shkelje administrative dhe dënohet me gjobë, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë. Masa administrative i vendoset titullarit të institucionit, administratorit të shoqërisë apo ndërmarrjes, që ka përgjegjësi administrimi pronën përkatëse.

Neni 6

Masat e veçanta për klientët familjarë dhe jofamiljarë privatë

Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për energjinë, në varësi të situatës miraton masa të detyrueshme për t'u zbatuar nga klientët familjarë dhe jofamiljarë privatë.

Neni 7

Masat e financimit për klientët familjarë për kursimin e energjisë nga panelet diellore

1. Agjencia për Eficiencën e Energjisë financon projektet për instalimin e paneleve diellore, për ngrohjen e ujit sanitar për klientët familjarë. Financimi përfshin jo më shumë se 70% të vlerës së impiantit dhe kostos së instalimit. Financimi i masës mbështetëse bëhet vetëm nga të ardhurat për shërbime ndaj të tretëve, të arkëtuara nga agjencia gjatë vitit buxhetor. Fondet e pashfrytëzuara për këtë qëllim mbarten në vitin pasardhës.

2. Agjencia për Eficiencën e Energjisë publikon në fazën e parë të procesit subjektet, që kanë shfaqur interes për ofrimin e shërbimit të shitjes dhe të instalimit të paneleve diellore për ngrohjen e ujit të ngrohtë.

3. Agjencia për Eficiencën e Energjisë në fazën e dytë realizon një procedurë të thjeshtuar për përfitimin e financimit nga klientët familjarë. Përzgjedhja e klientëve familjarë bëhet duke marrë për bazë kohën e aplikimit.

4. Instalimi i paneleve diellore monitorohet nga Task-Forca e Energjisë.

5. Agjencia për Eficiencën e Energjisë shpall në faqen e internetit rregullat dhe procedurat e detajuara për përfitimin e financimit.

6. Rregullat, procedurat dhe metodologjia për subjektet dhe klientët familjarë, objekt të kësaj mase mbështetëse, përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për energjinë.

Neni 8

Masa të tjera financimi për eficiencën e energjisë

1. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për energjinë, miraton masa shtesë financimi për projekte efience energjie për klientët familjarë dhe jofamiljarë, privatë ose publikë.

2. Financimi për masat e eficiencës financohet nga buxheti i shtetit ose nga donacione apo financime nga institucione kombëtare apo ndërkombëtare. Financimi për masat e eficiencës nga buxheti i shtetit realizohet në përputhje me legjislacionin për ndihmën shtetërore.

Neni 9

Organet kompetente për dhënien e masave administrative

1. Të drejtën e dhënies së masave administrative, sipas përcaktimeve të këtij akti normativ, e ka Task-Forca e Energjisë.

2. Masat administrative të dhëna, sipas këtij akti normativ, përbëjnë titull ekzekutiv dhe modeli i tyre përcaktohet nga organi kompetent.

3. Shqyrtimi dhe dhënia e masave administrative bëhen në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative.

Neni 10

Kohëzgjatja dhe zbatimi

1. Ky akt normativ ka karakter të përkohshëm dhe zbatohet për aq kohë sa zgjat periudha e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike.

2. Ky akt normativ nuk është i zbatueshëm për institucionet e ofrimit të shërbimeve shëndetësore, shkollat, kopshtet, komisariatet e policisë dhe institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale.

Neni 11

Hyrja në fuqi

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR
Belinda Balluku